

VENDIM
Nr. 835, datë 23.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 395, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

"6. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planveprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që përcakton shpalljen për thirrjet e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit."

2. Në pikën 7 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja "a" ndryshohet si më poshtë vijon:

"a) Dorëzimin pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Departamentit të Administratës Publike të numrit të praktikantëve për çdo thirrje."

b) Pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) Dërgon pranë Departamentit të Administratës Publike emrat e praktikantëve që rezultojnë fitues të procesit të përzgjedhjes për çdo thirrje, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e përfundimit të këtij procesi."

3. Pas pikës 11 shtohen pikat 11/1 dhe 11/2, me këtë përmbajtje:

"11/1. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të administrojë procesin e punësimit të praktikantëve në thirrjet e radhës, duke përcaktuar numrin e praktikantëve që do të punësohen me kontratë të përkohshme, bazuar në numrin e praktikantëve që do të kryejnë me sukses programin e praktikës, si dhe në kërkesat e institucioneve të administratës shtetërore për punësimin e përkohshëm të tyre.

11/2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i propozon Ministrisë së Financave numrin e praktikantëve që do të punësohen në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, me kontratë të përkohshme deri në një vit, për çdo institucion të administratës shtetërore."

4. Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

"13. Fondet e nevojshme financiare për zbatimin e pikave 11/1 dhe 11/2, të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë apo institucionin buxhetor, për shpenzimet për personelin, për vitin përkatës."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama